



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“NGRITJA E INFRASTRUKTURËS PËR MBËSHTETJEN E
KRIJIMIT TË PROGRAMIT TË FORMIMIT
MASTER NË PËRKTHIMIN E GJUHËS SË SHENJAVE”**

**FINANCUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE
INOVACIONIT NË KUADËR TË
PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR (PIKSH)
PËR VITIN 2023-2024**



EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI STROKA (koordinatore)

Anëtarë të personelit akademik

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri

Prof. Asoc. Dr. Etleva Koni (Kondi)

Dr. Elvana Shtëpani

Anëtarë të personelit administrativ

Znj. Klodeta Alushani

Z. Dejan Kushta

Periudha e zbatimit të projektit:

Faza 1 (infrastrukturë): korrik 2023 – dhjetor 2023

Faza 2 (trajtime): janar 2024 – maj 2024

PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës ndjen nevojën për të punuar lidhur me mundësinë e çeljes së një programi të ri në ciklin e dytë master për përkthimin dhe interpretimin e gjuhës së shenjave shqipe dhe ato internacionale.

Ky projekt ka në fokus ngritjen e infrastrukturës së domosdoshme me anën e dy laboratorëve specifik:

- një për zhvillimin dhe trajtimin e një kurrikule bashkëkohore të gjuhës së shenjave shqipe dhe internacionale, që do të rrisë ndjeshëm kapacitetet e mësuesve, përkthyesve e interpretuesve të rinj të gjuhës së shenjave shqipe dhe ato internacionale;
- dhe një laborator ku do të përgatisë infrastrukturën e duhur për ndërtimin sa më parë të një kurrikule mësimore për zhvillimin e mësimit në distancë.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës dhe të ndihmojë në koordinimin e aktiviteteve dhe nxitjen e sistemit arsimor gjithëpërfshirës të bazur në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës.

Gjithashtu nëpërmjet realizimit të këtij projekti synohet krijimi i mundësisë së formimit cilësor të të gjithë studentëve duke kontribuar në mirëqënien e tyre personale dhe duke reduktuar barrierat për studentët me aftësi ndryshe me qëllim përfshirjen dhe pjesëmarrjen në jetën akademike dhe studentore, duke krijuar mundësi edhe në rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programet e FGJH-UT.



OBJEKTIVAT

Në kuadër të gjithëpërfshirjes si edhe për të qenë më konkurrues në treg duke ofruar programe të reja studimore, FGJH-UT me anë të këtij projekti do të përgatisë infrastrukturën e duhur në mbështetje të krijimit të programit të formimit master në përkthimin e gjuhës së shenjave dhe për ngritjen e nje kurrikule zhvillimin e mësimit në distancë.



Projekti synon përmbushjen e objektivave të natyrës infrastrukturore dhe didaktike-mësimore me ngritjen e 2 (dy) laboratorëve të specializuar me bazën e nevojshme materiale për:

- ✓ krijimin e programit studimor master në përkthimin e gjuhës së shenjave;
- ✓ ndërtimin e një kurrikule mësimore për zhvillimin e mësimit në distancë.